

Raporti vjetor 2011

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet



Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Dhjetor 2011

RAPORT

Mbi detyrat e realizuara për vitin 2011

Mbrojtja nga rrezatimet e publikut, personelit dhe mjedisit për tani dhe për brezat e ardhshëm në Shqipëri është një proces në vazhdimësi, i cili kërkon një punë intensive të specialistëve të Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe të gjithë atyre institucioneve, të cilët janë të lidhur si me sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues. Stafi i ZMR ka punuar si çdo vit në zbatim të funksioneve që jep ligji për mbrojtjen nga rrezatimet, ku misioni kryesor ka qënë të përpunojë dokumentat legale për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut nga efektet e rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, i cili siguron mbrojtjen e publikut, personelit dhe mjedisit në perputhje dhe me standartet ndërkombetare si të ANEA-s dhe EU-së. Megjithë problemet e hasura puna në ZMR gjatë vitit 2011 ka pasur një ngritje dhe problematika për mbrojtjen nga rrezatimet ka ardhur në rënie.

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ka patur dhe ka në qendër të vëmendjes së tij sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues në Republikën e Shqipërisë .Në këtë kuadër ka gjetur mbështetje dhe udhëzimi bazë për detyrat kryesore dhe objektivat e vitit 2011.

Detyrat kresore për vitin 2011 ishin:

1. Mbledhje e dokumentacionit për subjektet private dhe shtetërore, të cilat aplikojnë për marrjen e licenses
2. Realizim inspektimesh në rang prefekturë, të cilat nuk kanë plotësuar të plotë dokumentacionin për licensim
3. Inspektim subjektësh, të cilave u ka kaluar afati i licensës dhe atyre që përdorin burime radioaktive, si për sigurinë dhe sigurimin.
4. Pjesëmarrje në projektet me BE dhe ANEA.
5. Përshtatja e legjislacionit tonë me atë të BE dhe plotësimi i matricës ligjore.
6. Bashkëpunim me departamentin e promocionit të ISHP për fillimin e një serie broshurash për promovimin e aktivitetit të zyrës dhe shpërndarjen e tyre në rang Republike
7. Përditësimi i inventarit kombëtar i të gjithë burimeve të rrezatimit jonizues në RSH
8. Instalimi i RAIS në version SQL

9.Fillimi i procedurave për sistemimin e programit SAT mbi vetëvlerësimin e trupës rregullatore.

10.Kërkesë për vlerësim nga ana e IAEA në lidhje me planin për përgatitjen dhe përballimin e emergjencave radiologjike meqënëse vetëm kjo fushë ka mbetur e pa vlerësuar nga ekspertë të jashtëm.

11. Rritje e nivelit tonë shkencor profesional nepërmjet kualifikimeve të ndryshme, seminareve apo trajnimeve, për të qënë sa më eficente në punën tonë të përditshme dhe në pjesëmarrjen në projektet që kemi në rang ndërkombëtar.

Matrica ligjore e parashikuar për vitin 2011

Projekt aktet	Objekti dhe qellimi i projektaktit	Ministri propozues	Afati i paraqitjes ne Qeveri
Projekt Ligji Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese	Plotesimi i kuadrit ligjor per mbrojtjen e publikut,punonjesve dhe mjedisit nga rrezatimet jonizuese	Ministri Shendetesise	4/2 (kater mujori I dyte)
Projekt VKM Per miratimin e rregullores "per percaktimin e niveleve kufi per percendrimin e radonit ne ndertesa, radioberthamave ne ushqime dhe materiale te	Plotesimi I kuadrit ligjire ne zbatim te ligjit Nr. 8025, date 09.11.1995 " Per rrezatimin jjonizues ", I ndryshuar	Ministri Shendetesise	4/1 (kater mujori I pare)
Projekt VKM Per miratimin e rregullores "Per mbrojtjen e punonjesve te ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese.	Plotesimi I kuadrit ligjire ne zbatim te ligjit Nr. 8025, date 09.11.1995 " Per rrezatimin jjonizues ", I ndryshuar	Ministri Shendetesise	4/2 (kater mujori I dyte)
Projekt VKM Per miratimin e rregullores "Per monitorimin e nivelit te radioaktivitetit ne mjedis	Plotesimi I kuadrit ligjire ne zbatim te ligjit Nr. 8025, date 09.11.1995 " Per rrezatimin jjonizues ", I ndryshuar	Ministri Shendetesise	4/2 (kater mujori I dyte)

Në mbështetje të planit të punës për vitin 2011, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga

Rrezatimet ka realizuar me përpikmëri detyrat e përcaktuara. Këto detyra lidhen me pranimin e dokumentacionit të aplikuesve për marrjen e licensës; vlerësimi i aplikimeve për licensë; inspektimi i kabineteve radiologjike si dhe subjektet që përdorin burime të hapura dhe të mbyllura në Republikën e Shqipërisë; lejet e import/eksportit, transportit dhe transferimit të burimeve të rrezatimit jonizues; etj.

-INSPEKTIMI

Bazuar në planin vjetor për vitin 2011, prioritet gjatë kësaj periudhe për këtë zyrë ka qënë realizimi i inspektimeve në rang prefekturë, duke i dhënë prioritet qyteteve dhe prefekturave, të cilat nuk u realizuan gjatë 2010 si dhe inspektim subjektësh , të cilave u ka kaluar afati i licensës, duke mbajtur qëndrim ligjor, sic e përcakton rregullorja e sanksioneve. Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2011 janë kryer inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive.

Inspektimet e realizuara gjatë 2011:


Subjekte Shtetërore:

1. Spitali Rajonal Gjirokastrë
2. Spitali Rajonal Sarandë
3. Spitali Delvinë
4. Spitali Rajonal Përmet
5. Spitali Rajonal Tepelenë
6. Spitali Rajonal Durrës
7. Spitali Rajonal Kavajë,
8. Qendra Shëndetësore Shijak
9. Spitali Rajonal Korçë
10. Spitali Rajonal dhe Poliklinikë, Pogradec
11. Spitali Rajonal Kukës
12. Spitali Rajonal Has,
13. Spitali Rajonal Rrëshen
14. Spitali Rajonal Shkodër
15. Spitali Rajonal Lezhë
16. Spitali Rajonal dhe Poliklinikë Berat,
17. Spitali Corovodë
18. Spitali Rajonal, Dispanceri dhe Poliklinikë, Lushnjë
19. Spitali Rajonal Fier,
20. Spitali Rajonal, Dispanceri dhe Poliklinikë, Vlorë
21. Spitali Rajonal Peshkopi
22. Spitali Bulqizë
23. Spitali Burrel

- 24.Spitali Rajonal Pukë
- 25.Spitali Rajonal Tropojë
- 26.QSUT Onkologjik
- 27. QFBZ
- 28.Qendra Spitalore Universitare “Shefqet Ndroqi”,Tiranë
- 29.QSUT Radiologji

Subjekte Private:

- 1. Klinika Luis(Balloma),Gjirokastër,
- 2. Kompania Trebeshina,Kelcyrë
- 3. Hygeia Hospital,
- 4. Klinika Radiologjike Gollosi
- 5. Klinika Kristi,Korce
- 6. Klinika Radiologjike Gega,Vlorë
- 7. Klinika Radiologjike Medic Alba,Fier
- 8. QSHNG
- 9. Klinika Aks,Korcë
- 10.Klinika Medicare,Durrës
- 11.Klinika Enesi,Durrës
- 12.Klinika radiologjike dentare Ismailaj,Tiranë
- 13.Spitali Amerikan,Durrës
- 14. Klinika Radiologjike Medic Alba,Vlorë
- 15.Klinika dentare Hasanaj,Tiranë
- 16.Qendra e grafisë dentare Nr.1,Tiranë



Grafik 1

Në grafikun 1 është paraqitur nr i inspektimeve të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2011. Në ndryshim nga vitet e tjera vihet re se inspektimi gjatë këtij viti ka qënë i përqëndruar në qendrat spitalore shtetërore.

-LICENSIMI

Në zbatim të ligjit Nr.8025 datë 09/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”,i ndryshuar si dhe rregullores mbi “Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”Nr.10 datë07/01/2010,procesi i licensimit ka vazhduar normalisht dhe gjatë këtij ,që nga e faza e parë që është njoftimi e deri në fazën e fundit që është miratimi ose jo i licensës.

Janë miratuar nga KMR 34 licensa,nga të cilat 4 janë licensa te reja, 28 janë rinovim license, ndërsa 2 subjekte kanë amenduar licensën si rezultat i zgjerimit të aktivitetit, 1 licensë është revokuar nga KMR për arsye se ndërtimi i këtij kabineti nuk ishte në përputhje me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë nr.415 datë 11.10.2011. Gjithashtu KMR ka miratuar dhe fazën e parë të ndërtimit për disa nga spitalet shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Licensat e miratuara nga KMR për këtë vit janë si më poshtë vijon:

- 1-Biometric-Albania,Tiranë(import-eksport të burimeve të rrezatimit jonizues)
- 2-Klinika radiologjike dentare,Tiranë(Panoramex)
- 3-Klinika Imazherike “Gollosi”,Tiranë (grafi/skopi dhe panoramex)
- 4-Qendra Diagnostikuese“Medicare”, Tiranë (import,transport dhe përdorim të lëndëve të hapura radioactive I-131 dhe Tc-99m)
- 5-Qendra e Mjekësisë Bërthamore,QSU “Nënë Tereza”,Tiranë(import dhe përdorim të lëndëve të hapura radioactive I-131 dhe Tc-99m)
- 6-Amendim i licensës për Spitalin Univers-Alb,Tiranë(import dhe përdorim I lëndëve të hapura radioactive I-131 dhe Tc-99m,të cilat do të përdoren tashme dhe për terapinë e tumoreve të ndryshme të tiroides)
- 7-Departamenti i Radioterapisë,Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”,Tiranë (Co-60,Ir-192,Therapax DXT 300,X-ray)
- 8-Qendra “Medicare”(CT-Skaner,të cilat janë instaluar që qytetet Tiranë,Elbasan,Fier,Berat,Shkodër dhe Durrës si dhe një pajisje grafi/skopi dhe një grafi)
- 9--Klinika Diplomat,Tiranë (panorameks,grafi/skopi)
- 10-QSHNG,Patos,Fier(2 burime Am-241Be dhe 3 burime Cs-137)
- 11-Royal Diagnostic Center,Tiranë (CT-Skaner,Grafi,Mamografi)
- 12-Univers- Alb, Radiologji dhe Mjekësi Bërthamore (Tirana 1, Tirana 2, Durrës, Fier)
- 13-Weatherford Services L.T.D,Fier (2 burime Am-241Be,2 burime Cs-137 dhe Ra-226 ose rere monocite)
- 14-Spitali European (Mamografi,CT-Skaner,Koronarografi,Grafi/Skopi)

- 15-Klinika Ndreu,Durrës (Grafi/Skopi)
- 16-Klinika “Logli”,Gjirokastër (CT-Skaner)
- 17-QSUT,Tiranë(Radiologjia)
- 18-Spitali Rajonal Durrës (3 pajisje Grafi/skopi dhe 1 pajisje mamografi)
- 19-Klinika “La vita”,Kavajë (Grafi/skopi)
- 20-Kompania “MedFau”,Kavajë (import-eksport të gjeneratorëve me rreze X)
- 21-Laboratori “Neo-Style”,Tiranë (diagnostikim RIA dhe Bone densitometri)
- 22-Qendra e Fizikës Bërthamorë të Zbatuar,Tiranë(përdorim, transport, ruajtje, import-eksport të burimeve të rrezatimit jonizues si dhe trajtim të mbetjeve radioaktive)
- 23-Glob Diagnostic Center,Tiranë (Grafi,mamografi dhe CT-Skaner)
- 24-FMES,Tiranë (Coronarografi)
- 25-SFI,Spille, Kavaje (Grafi)
- 26-Alba Medic, Fier (CT-Skaner dhe Grafi)
- 27-Klinika dentare Veizaj, Tiranë (panorameks dhe grafi dentare)
- 28-Klinika radiologjike Balloma, Gjirokastër (CT-Skaner)
- 29-Amendim i licensës QSUT,Mjekësia Bërthamore (Terapi me I-131)
- 30-Studio Gega,Vlorë (CT-Skaner, Mamografi, Grafi/Skopi, Panorameks)
- 31-Shoqëria “Vëllezërit Elezi Arusha e Ndërtimit”, Durrës (grafi industriale me rreze X)
- 32-Klinika Radiologjike Kristi,Korçë(CT-Skaner,Mamografi, Panorameks, Grafi dentare)
- 33- Klinika radiologjike Ismailaj, Tiranë (Panorameks dhe Grafi dentare)
- 34-Klinika ”3 Yjet”, Tiranë (Grafi/skopi dhe Panorameks)

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” Nr.8025,datë 9/11/1995,i ndryshuar,neni 3 si dhe rregullores mbi “Licënsimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” Nr.10 datë .7.01.2010,pika 3 ku theksohet se në rastin e ndërtimit me faza të një praktike që përfshihet në aktivitetet e përshkruara në nenin 3 të ligjit, KMR miratoi fazën e parë të ndërtimit të kabineteve të radiologjisë në spitalet rajonale të qyteteve:Gjirokastër,Kukës,Elbasan,Peshkopi,Sarandë dhe Lushnjë.


Për të gjithë këto subjekte është krijuar një dosje e vecantë dhe është bërë vlerësimi përkatës nga inspektori sipas formatit të përshtatur dhe unifikuar nga ZMR.

Në tabelën 1 është bërë një shpërndarje e burimeve të rrezatimit jonizues, sipas aparaturave me rreze X, burimeve radioaktive të mbyllura dhe të hapura, të cilat përdoren nga subjekte të ndryshme në fushën e mjekësisë,industrisë apo edukimit dhe shkencës dhe që janë licensuar gjatë 2011


Lloji	CT	Mamo	Grafi+ litotript	Gr/dent dhe panor.	GR/Sk	Corona Rografi	Grafi industriale me rreze X	Burime rad të mbyllura	Burime rad te hapura	C- Arm
nr	23	10	27grafi+ 2 litotript	12	15	6	1	Kategori I dhe III,IV dhe V (4 qendra)	3	7

Tabela 1

Më poshtë kemi paraqitur dhe në mënyrë grafike nr e burimeve të rrezatimit jonizues të licensuar gjatë vitit 2011.



Grafik 2



Grafik 3

Në grafikun 3 kemi paraqitur nr e licensave të miratuara gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011. Vihet re se gjatë këtyre tre viteve nr i licensave të miratuara nga KMR është pothuajse i njëjtë.

-IMPORT-EKSPORTI

Procesi i import –eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158 datë 13/02/2008, udhëzuesin mbi import-eksportet e materialeve radioaktive Nr.4756/1, datë 21/12/2006 dhe rregulloren për “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive”, Nr.3918/4, datë 3/11/2004. Gjatë vitit 2011 KMR ka miratuar në mbledhjen e tij datë 31 Janar 2011 dhe formatin e ri të aprovimit për import-eksport. Gjithashtu në përputhje me HASS directive 2003/122 Euroatom është aprovuar dhe formati i aprovimit për transferimin e burimeve nga një institucion në tjetrin.

Gjatë vitit 2011 janë dhënë 123 aprovime importi, katër prej të cilave nuk janë ekzekutuar për arsye teknike të subjekteve .Gjatë këtij viti janë kryer kryesisht importe të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit B, C dhe D, si dhe burime të hapura radioaktive të cilat kryesisht përdoren për ekzaminime “in Vitro” dhe “in Vivo”.

Për sa i takon eksporteve, gjatë 2011 janë eksportuar 3 burime Ir-192 dhe 3 pajisje Troxler me burim radioaktiv të incorporuar në të, të cilat janë përdorur nga subjektet për qëllime mjekësore ose industriale. Eksporti është kryer sipas kontratave të nënshkruara për kthimin e

burimeve radioaktive tek prodhuesi në fund të jetës së tij. Kthimi i burimit tek prodhuesi në fund të përdorimit ka qënë një nga strategjitë e punës tonë në mënyrë që të krijohen sa më pak mbetje në vend. Gjatë 2011 është dhënë vetëm një aprovim transferimi për Kurum International, i cili në bazë të kontratës me QFBZ, transferoi 2 burime Co-60 në LMR.

Më poshtë po paraqesim shpërndarjen e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë vitit 2011 në mënyrë tabelore dhe grafike. Gjatë vitit 2011 vihet re një dyfishim i numrit të importeve, si rezultat i shtimit të numrit të subjekteve të licensuar, të cilët përdorin burime të rrezatimit jonizues në mjekësi, industri apo kërkime shkencore.

Nr i aprovimeve mbi importin e burimeve të rrezatimit jonizues

Medicare	Kurum	Nasto Inxh.	Univers Alb	Neo Style	Domi	Hygeia Hospital	QSUT	QFBZ	Fushe kruje
26	1	1	29	15	2	23	18	2	1
Ëeatherford Services									
1(3 nuk jane realizuar)									


Tabela 2

Nr i aprovimeve për eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues

Nasto inxhiniering	Bechtel Enka	Ekokem Palvelu	QSUT
2(Ir-192)	1(Troxler)	1(Troxler)	1(Ir-192)


Tabela 3

Në grafikun 4 është paraqitur një shpërndarje e aprovimeve për import të burimeve të rrezatimit jonizues sipas kompanive të licensuara, të dhëna gjatë vitit 2011




Grafik 4

Në grafikun 5 është paraqitur nr i eksporteve te burime të rrezatimit jonizues gjatë 2011 sipas subjekteve.



Grafik 5



Grafik 6

Në grafikun 6 është krahasuar nr i import-eksporteve të miratuara gjatë vitit 2011 me import-eksportet e kryera gjatë 2009 dhe 2010. Nga grafiku vihet re se gjate vitit 2011 kemi një dyfishim te importeve dhe eksporteve.

-TRANSPORTI


Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licensuar nga KMR dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” Nr.488 datë 23.06.2010, si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin. Kompani të licensuara për kryerjen e transportin janë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, e cila është dhe e vetmja qendër e licensuar për kryerjen e transportit për të tretë, gjithashtu janë të lincsuara Qendra diagnostikuese Medicare dhe Hygeia Hospital, të cilët janë të detyruar të kryejnë transport vetëm për interesa të kompanisë së tyre dhe jo për të tretë.

Në lidhje me aprovimet e lëshuara nga ZMR për transportin, gjatë kësaj periudhe janë dhënë 122 aprovime transporti për burime të hapura dhe të mbyllura, nga të cilat 113 janë transport për burime të hapura, të cilat përdoren në mjekësi për diagnostikim “in Vitro” dhe “In Vivo”, ndërsa 9 prej tyre janë aprovime transporti për burime të mbyllura radioaktive ,të cilat përfshihen në grupin e sigurimit B,C dhe D si dhe përdoren në fushën e mjekësisë dhe industrisë. Katër nga këto nga këto aprovime nuk janë ekzekutuar për arsye teknike të subjektit.

Më mëposhtë po paraqesim një shpërndarje në mënyrë tabelore dhe grafike të aprovimeve të dhëna për këtë vit.


Nr.i aprovimeve për transportin	
Medicare,QFBZ,HygeiaHospital Burime të hapura	Qendra e Fizikës Bërthamore e Zbatuar, burime të mbyllura
113	9

Tabela 4



Grafik 7

Në grafën 8 është paraqitur me përqindje nr i aprovimeve për transport të dhëna për vitin 2011 të krahasuara me vitin 2009 dhe 2010



Grafik 8

-MBLEDHJET E KMR-së

Gjatë këtij viti janë realizuar 4 mbledhje të KMR ku dhe janë marrë disa vendime.

KMR ka miratuar kriteret e njohjes së ekspertëve të mbrojtjes nga rrezatimi. Në grupin e parë KMR do të njohë si ekspertë ato persona të cilët deri më datë 31 Dhjetor 2010 plotësojnë kushtet e mëposhtme :

Kritere Vleresimi :

- 1-Diplomë në degën e fizikës pesëvjecare ose master në fizikë ose diplomë në inxhinieri ose master në inxhinieri
- 2-Eksperiencë pune prej 7 vitesh në këtë fushë
- 3-Kualifikime të ndryshme në fushën e rrezatimeve jonizuese, të cilat të përfshijnë: Bazat e fizikës bërthamore
Efektin biologjik të rrezatimeve jonizuese
Dedektorët,statistikat e matjeve
Radiometri
Dozimetri,
Përcaktime të trashësisë së veshjeve
Legjislacionin.

Pas datës 31 Dhjetor 2010, KMR do të njohë si eksperte personat të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- 1-Diplomë fizikë /inxhinieri pesëvjecare,ose master në fizikë

2-Kursin 3 mujor pranë Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar,programi i të cilit është miratuar në mbledhjen e KMR datë 23.12.2010 ku trajnimi do të përfshijë kursin e plotë të radiometrisë dhe dozimetrisë sic e përcakton QFBZ në programet e trajnimit.

3-Eksperiencë pune prej 7 vitesh.

KMR ka miratuar gjatë vitit 2011 dokumentat si më poshtë:

Formatet mbi aprovimin për:

-import-eksport të burimeve radioaktive të kategorisë I dhe II Nr .494/2 datë 07.02.2011

-import-eksport për burime të kategorisë III,IV dhe V Nr.494/3 datë 07.02.2011

- import-eksport të gjeneratorëve me rreze X, Nr.494/6 datë 07.02.2011

-transport të burimeve radioactive Nr.494/5 datë 07.02.2011

-transferimit të burimeve radioaktive Nr.494/4 datë 07.02.2011

-Procedurat e vlerësimit të aplikimit për licensë të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues,Inspektimi,protikolli i inspektimit,modeli i përgatitjes së raportit të inspektimit,formati shpjegues në lidhje me plotësimin e aplikimit për licensë,formati i dorëzimit të aplikimit,modeli i vlerësimit të aplikimit. Nr.494/7 datë 07.02.2011

-Udhëzuesin mbi “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive të kategorive I dhe II në Republikën e Shqipërisë”Nr.1438/2 datë 12.04.2011

Programet e trajnimit Nr 1438/6 datë 12.04.2011:

-Përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet,

-Ekspert i kualifikuar,

-Punonjës që përdor burime të rrezatimit jonizues dhe

-Punonjës i trupës rregullatore.

-Si dhe, Procedurat e vlerësimit të aplikimit si ekspert i kualifikuar.1438/7 datë 12.04.2011

Është miratuar lista e ekspertëve të kualifikuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet

Gjithashtu është miratuar dhe modeli mbi :

Proçes –Verbalin dhe Vendimin për zbatim nga ana e inspektorëve Nr 1438/5 darë 12.04.2011

Në zbatim të kësaj është përgatitur dhe blloku i gjobave.

Gjatë këtij viti KMR ka punuar në lidhje me dokumentin mbi “Strategjia dhe Politika kombëtare mbi menaxhimin e mbetjeve radioactive në Republikën e Shqipërisë”, dokument i cili është përgatitur duke u mbështetur në materialet e ANEA-s si dhe duke e përshtatur me kushtet specifike të Shqipërisë.Objektivi kryesor i këtij dokumenti është të vendosë elementët kryesore të politikave dhe strategjisë kombëtare për një menaxhim të sigurtë të mbetjeve radioaktive. Standartet e sigurisë për menaxhimin e mbetjeve radioaktive,si dhe metodat e aplikuara duhet

të jenë në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare si dhe me situatën kombëtare.

Dokumenti mbi “Strategjinë dhe politikën kombëtare mbi menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” nuk ka marrë formën përfundimtare dhe mendohet që brenda katërmujorit të parë të vitit 2012 të miratohet nga KMR.

ZMR ka përgatitur gjatë 2011 raportin kombëtar mbi “Konventën e Bashkuar për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive”. Parlamenti Shqiptar ka miratuar ligjin për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bashkuar më 24 Shkurt 2011. Shqipëria ka depozituar një instrument të aderimit të Konventës së Bashkuar më 29 Qershor 2011, e cila ka hyrë në fuqi më 27 Shator 2011. Në zbatim të nenit 32, të këtij ligji, ku çdo Palë Kontraktuese duhet të paraqesë një Raport Kombëtar për çdo takim shqyrtues, Shqipëria ka përgatitur raportin kombëtar, i cili paraqet të gjitha pikat që kanë të bëjnë me menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive. Në lidhje me menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar Shqipëria ende nuk është pjesë e saj.

Është punuar dhe në lidhje me Memorandumin e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Sigurisë nga Rrezatimi të Republikës së Maqedonisë dhe Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu është përgatitur dhe Memorandumi i Mirkuptimit me Agjencinë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Sigurinë Berthamore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i informacioneve teknike dhe eksperiencave në fushën e rrezatimeve jonizuese.

Vlen të përmendet se gjatë këtij viti Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka nisur bashkëpunimin me Agjencinë e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në Shqipëri. Ndoshta, në të ardhmen do të punohet dhe për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me këtë institucion.

Sipas drejtimeve kryesore të punës tonë për vitin 2011, një nga pikat e këtij dokumenti ishte dhe kërkesa për vlerësim nga ana e IAEA-s, në lidhje me planin për përgatitjen dhe përballimin e emergjencave radiologjike, meqenëse vetëm kjo fushë kishte mbetur e pa vlerësuar nga ekspertë të jashtëm. Për këtë çështje gjatë periudhës 21-25 Nëntor 2011 erdhi në Shqipëri misioni EPREV, qëllimi i të cilit ishte vlerësimi i Planit të Përballimit të Emergjencave në Shqipëri. Pjesë e këtij vlerësimi ishin dhe dy institucione kryesore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me emergjencat, Qendra e Fizikës Berthamore të Zbatuar si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Ekspertët e misionit EPREV, bënë një vlerësim të situatës si dhe është përgatitur një draft raport me rekomandimet e tyre në lidhje me këtë çështje.

Monitorimi i mjedisit ka qënë gjithashtu një objektiv kryesor për KMR. Në lidhje me këtë pikë është përgatitur rregullorja për monitorimin e mjedisit, në perputhje me Direktivën 35 të BE-së (Euratom Treaty), ku kërkohet se çdo shtet anëtar i BE duhet të krijojë strukturën dhe bazën e nevojshme materiale për të realizuar monitorimin e vazhdueshëm të niveleve të radioaktivitetit në ujë, tokë dhe ajër dhe të garantojë që këto nivele të jenë brenda normave të vendosura nga komiteti ndërkombëtar. Draft rregullorja është dërguar për mendim në ministritë e linjës.

Gjatë të këtij viti janë miratuar nga Këshilli i Ministrave tre rregullore si më poshtë:

- 1-Rregullore “Për nivelet e lejuara të përqëndrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike“ Nr.591 datë 18.08.2011
- 2-Rregullore “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimev jonizuese” Nr.590 datë 18.08.2011
- 3-Rregullore “Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë“ Nr.344 datë 29.04.2011

Janë miratuar nga Parlamenti Shqiptar:

- 1- Ligji për “Mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” Nr.10 469, datë 13.10.2011
- 2-Ligji për Aderimin e Shqipërisë në Konvetën e bashkuar për sigurinë dhe menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar dhe trajtimin e mbetjeve radioaktive” Nr. 10379, datë 24.02.2011
- 3-Ligji për Aderimin e Shqipërisë në Konventën për Sigurinë Bërthamore Nr.10380, date 24.02.2011

ZMR ka përgatitur dhe matricën ligjore për vitin 2012, gjatë të cilit do të realizohen:

- 1-Rregullore mbi sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve me burime te rrezatimeve jonizuese (katërmujoti i tretë)
- 2- Rregullore mbi sigurinë ndaj ekspozimeve mjeksore me burime te rrezatimeve jonizuese.(katëmujori i tretë)
- 3- Rregullore mbi sigurinë e punonjesve dhe publikut ndaj ekspozimeve te rrezatimeve jojonizuese (katëmujori i dytë)

-Problematika

Një nga problematikat kryesore të këtij viti ka qënë në lidhje me fizikanët mjekësorë, roli i tyre, përcaktimi i kriterëve dhe faza tranzitore.

Një problem i ngritur me të drejtë dhe që është diskutuar gjatë pasi fizikanët të cilët punojnë në qendrat spitalore, janë të specializuar por nuk gëzojnë titullin si Fizikan Mjekësor.

Për këtë çështje është ngritur një grup pune dhe po punohet për adaptimin e disa kriterëve. Në bazë të këtyre kriterëve do të bëhet dhe certifikimi i stafit që aktualisht është i specializuar dhe punon në qendrat kryesore spitalore në vend. Gjithashtu grupi i punës do të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit që në të ardhmen fizika mjekësore të jetë pjesë e procesit mësimor pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Një problematikë tjetër ka qënë plotësimi i dokumentacionit nga spitalet rajonale shtetërore në rrethe, ku shumë prej tyre e kanë nisur këtë proces, por nuk është vazhduar më tej si rezultat i neglizhencës apo vështirësive për plotësimin e tyre dhe pse kanë pasur mbeshtetje nga ana jone në cdo moment. Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë disa urdhëra, në mënyrë që të nxisin këto subjekte për vazhdimin e procesit për licensim, por që deri tani nuk kanë pasur rezultat.

Gjithashtu një problematikë tjetër e cila është diskutuar gjatë nga KMR ka qënë ndërtimi i kabinetëve me veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në godinat e destinuar për banim. Ministri i shëndetësisë, njëkohësisht dhe Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, duke marrë shkas dhe nga letër ankesat e banorëve ka nxjerrë urdhërin Nr.415 datë 11.10.2011, i cili ndalon ndërtimin e këtyre kabinetëve në ambiente të destinuar për banim.

PKMZSA

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet po punon dhe për përshtatjen e legjislacionit shqiptar, që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi me legjislacionin europian në kuadër të integritit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritit Europian . Ky dokument

strategjik përfshin iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të prioritetëve të adresuara nga Dokumenti i Partneritetit Europian (2007) dhe Raporti Vjetor i KE (2009), si dhe ka filluar puna për PKZMSA-në e re do të jetë një pikë e rëndësishme referimi për negociatat e ardhshme me BE-në duke u bazuar në edhe në Progres-raportet vjetore të Komisionit Europian, sidomos Raporti Analitik i Komisionit i datës 9 nëntor 2010, SEC (2010) 1335, që ofron një panoramë të situatës në Shqipëri dhe identifikon një numër prioritetesh afatshkurtra dhe afatmesme, si edhe Progres-raporti 2011 i datës 12 tetor 2011, SEC (2011) 1205.

Gjate këtij viti është siguruar pjesëmarrja në takimet e Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal”, si dhe janë përgatitur raportet përkatëse.

Është punuar sipas metodologjisë së përditësimit të PKZMSA dhe me sistemin online. Gjatë 2011 ZMR ka punuar dhe raportuar për progres raportin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

BDTI

Shqipëria është bërë përfshirë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Ilegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR ka vazhduar punën me mbledhjen e të dhënave dhe sistemin e këtij lloj informacioni në bashkëpunim me Institucione të tjera shtetërore shqiptare dhe me Agjencinë. Ky informacion përshtatet në një format në përputhje me dokumentat e ANEA-s, ku përshkruhet natyra e incidentit, si dhe ndarja në kategori e saj. Informacioni i marre arkivohet pranë ZMR i kategorizuar sipas burimeve radioaktive.

SEMINARE, TAKIME DHE TRAJNIME

Është siguruar pjesëmarrja në seminare e takime të nivelit ndërkombëtar, sic mund të përmendim:

-Vlerësimi i nevojave dhe veprimet e propozuara për të forcuar sigurinë dhe mbrojtjen e burimeve radioaktive në vend.Vienë, Austri ,17 -18 Janar 2011

-Takim Rajonal mbi rishikimin e Planit individual të punës,Vienë Austri 26-29 Shtator 2011

-Kurs Rajonal mbi aplikimin e kerkesave ndërkombëtare dhe udhëzuesin mbi zhvillimin e kapaciteteve kombëtare për reagimin ndaj një emergjence,Nicosia,Cyprus,17-22 Tetor 2011

-Kurs Trajnimi për Oficerët e Mbrojtjes nga Rrezatimi, Lituani, 09-13 Maj 2011

- Konferencë për kërkimin , inovacionin, arsimimin dhe trajnimin,Tiranë 8-9 Nëntor 2011

-Kurs Trajnimi mbi Komunikimin gjatë një Emergjencë Nukleare ose Radiologjike, Zagreb, Kroaci, 7-11 Nëntor 2011

- Trajnim mbi analizën e mungesave në legjislacion për mbrojtjen e të dhënave, Kapitulli 15 i EU Acquis, 05 Korrik 2011, Tirane

- Takim i Nënkomitetit mbi Transportin, Energjinë, Mjedisin si dhe Zhvillimin Rajonal ,Tiranë, 15-16 Qershor 2011